

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
(me raportin e auditorëve të pavarur)

Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i auditorëve të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim dhe humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4-5
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	6-30



KPMG Albania Shpk
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Tiranë, 25 mars 2016

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2015, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave përmbledhëse të tjera, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidencia e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Fatos Beqja
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e pozicionit financiar

(shumat ne Lek)

	Shënimi	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktivët			
Toka, ndërtesa dhe makineri	6	1,109,523,353	1,149,042,986
Investime financiare	7	23,000,000	23,000,000
Tatimi i shtyrë	24	1,620,190	929,016
Totali i aktiveve afatgjata		1,134,143,543	1,172,972,002
Inventari	8	221,835,910	253,298,947
Kërkesa për arkëtim nga debitorët	9	20,103,125	98,637,249
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	10	21,092,486	43,626,104
Aktive të tjera afatshkurtra	11	26,413,719	52,513,162
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	783,446,105	536,461,056
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,072,891,345	984,536,518
Totali i aktiveve		2,207,034,888	2,157,508,520
Detyrimet dhe kapitalet e veta			
Kapitali i nënshkruar	13	1,493,040,000	1,493,040,000
Rezerva ligjore	14	29,987,807	29,987,807
Rezerva të tjera		41,264,800	41,264,800
Fitimi i mbartur		250,795,810	174,001,205
Totali i kapitalit aksionar		1,815,088,417	1,738,293,812
Tatim i shtyrë	24	27,200,368	27,200,368
Totali i detyrimeve afatgjata		27,200,368	27,200,368
Detyrime ndaj palëve të lidhura	15	12,978,637	15,289,181
Detyrime ndaj furnitorëve	16	203,975,981	265,899,163
Tatim fitimi pagueshëm		19,453,037	6,267,700
Detyrime të tjera	17	128,338,448	104,558,296
Totali i detyrimeve afatshkurtra		364,746,103	392,014,340
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve të veta		2,207,034,888	2,157,508,520

Shënimet, në faqet 6 deri 30, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e fitim dhe humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse

(shumat në Lek)

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	
		2015	2014
Të ardhurat nga shitjet	18	2,950,823,961	2,834,007,280
Kostoja e mallrave të shitura	19	<u>(1,973,480,345)</u>	<u>(1,951,971,404)</u>
Fitimi bruto		<u>977,343,616</u>	<u>882,035,876</u>
Të ardhura të tjera	20	227,138,715	175,156,260
Shpenzime personeli	21	(353,557,730)	(372,779,616)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	(62,577,667)	(56,212,243)
Shpenzime të tjera operative	22	<u>(490,575,407)</u>	<u>(444,214,938)</u>
Shpenzimet neto		<u>(679,572,089)</u>	<u>(698,050,537)</u>
Fitimi operativ nga veprimtaria e shfrytëzimit		297,771,527	183,985,339
Shpenzime financiare		(26,432,738)	(13,011,964)
Të ardhura financiare		<u>13,735,932</u>	<u>18,709,062</u>
Të ardhura/(humbje) financiare neto	23	<u>(12,696,806)</u>	<u>5,697,098</u>
Fitimi para tatimit		285,074,721	189,682,437
Tatimi mbi fitimin	24	(51,156,203)	(32,558,524)
Fitimi neto i vitit		<u>233,918,518</u>	<u>157,123,913</u>
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Fitimi përmbledhës për vitin		<u>233,918,518</u>	<u>157,123,913</u>

Shënimet, në faqet 6 deri 30, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014

(shumat në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 Janar 2014	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	161,962,205	1,726,254,812
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën					
Fitimi neto i vitit	-	-	-	157,123,913	157,123,913
Të ardhura të tjera përmbledhëse, në neto të tatimit mbi fitimin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të periudhës	-	-	-	157,123,913	157,123,913
Transaksione me pronarët e Shoqërisë					
Kontribut dhe shpërndarje					
Shpërndarja e fitimeve të mbartura	-	-	-	(145,084,913)	(145,084,913)
Totali i kontributit dhe shpërndarjeve	-	-	-	(145,084,913)	(145,084,913)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	174,001,205	1,738,293,812
Gjendja më 1 Janar 2015	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	174,001,205	1,738,293,812
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën					
Fitimi neto i vitit	-	-	-	233,918,518	233,918,518
Të ardhura të tjera përmbledhëse, në neto të tatimit mbi fitimin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të periudhës	-	-	-	233,918,518	233,918,518
Transaksione me pronarët e Shoqërisë					
Kontribut dhe Shpërndarje					
Shpërndarja e fitimeve të mbartura	-	-	-	(157,123,913)	(157,123,913)
Totali i kontributit dhe shpërndarjeve	-	-	-	(157,123,913)	(157,123,913)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	250,795,810	1,815,088,417

Shënimet, në faqet 6 deri 30, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e flukseve monetare

(shumat në Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	
	2015	2014
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi neto i periudhës:	233,918,518	157,123,913
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	132,846,241	142,014,782
(Fitim)/humbje nga shitja e aktiveve materiale	(5,753,595)	1,280,372
Nxjertje jashtë përdorimi e aktiveve materiale	12,200,740	9,602,902
Provizjion per inventar	21,235,895	7,469,083
Tatim fitimi	51,156,203	32,558,524
Të ardhura nga interesi	(13,735,932)	(18,709,062)
	431,868,070	331,340,514
<i>Ndryshime në:</i>		
Inventarë	10,227,142	(46,799,706)
Mjete monetare të kushtëzuara	(128,700,000)	(140,020,000)
Kërkesa për arkëtim nga palë te lidhura	22,533,618	(36,784,823)
Kërkesa për arkëtim nga klientë	78,534,124	(47,863,387)
Kërkesa të tjera për arkëtim	28,214,856	8,255,794
Detyrim ndaj palëve te lidhura	(2,310,544)	12,553,710
Detyrimet ndaj furnitorëve	(61,923,182)	96,370,676
Detyrimet te tjera të pagueshme	23,780,152	(40,881,711)
Mjete monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit	402,224,236	136,171,067
Tatimi mbi fitimin i paguar	(38,662,040)	(28,309,923)
Interesa të arkëtuar	11,620,520	17,367,519
Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	375,182,716	125,228,663
Mjete monetare nga aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(108,727,191)	(84,635,035)
Arkëtim nga shitja e aktiveve materiale	8,953,437	1,342,784
Mjete monetare neto nga veprimtaritë investuese	(99,773,754)	(83,292,251)

Shënimet, në faqet 6 deri 30, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k


Pasqyra e flukseve monetare


(shumat në Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	
	2015	2014
Mjete monetare nga aktiviteti financues		
Dividentë të paguar	<u>(157,123,913)</u>	<u>(145,084,913)</u>
Mjete monetare neto nga veprimtaritë e financimit	<u>(157,123,913)</u>	<u>(145,084,913)</u>
(Pakësimi)/ rritja neto i mjeteve monetare dhe ekuivalente me to	118,285,049	(103,148,501)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në 1 Janar	<u>116,041,056</u>	<u>219,189,557</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor (shënimi 13)	<u>234,326,105</u>	<u>116,041,056</u>

Shënimet, në faqet 6 deri 30, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Këshilli i Administrimit të Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k. më 17 Mars 2016 dhe u firmosën në emër të tyre nga Drejtuesit e Shoqërisë më 25 Mars 2016 nga:


Ervina Kuta
Drejtore Administrativ dhe Financiar


Luigi Yerardo
Drejtore i Përgjithshëm

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

1. Entiteti raportues

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar në Qershor të 1993, si një shoqëri me kapital të përbashkët ndërmjet Aziende Commerciali Industriali e Servizi s.r.l. ("ACIES") një shoqëri italiane me zyrat qendrore në Bolonja, Itali; The Coca-Cola Export Corporation ("TCCEC"), e themeluar në shtetin e Delaware, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe Invest P.F., një Shoqëri shqiptare me kapital shtetëror me zyrat qendrore në Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria është angazhuar në prodhimin, mbushjen dhe shitjen e të gjitha produkteve të markës Coca-Cola në Shqipëri, sipas një kontrate franchize ekskluzive me Shoqërinë Coca-Cola.

Aksionerët e shoqërisë dhe kuotat e kapitalit respektivë janë si më poshtë:

Aksionarët	Në %	
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
SIBEG S.r.l	74.69	74.69
TCCEC	22.65	22.65
INVEST P.F.	2.66	2.66
	100.00	100.00

Gjatë vitit 2015 nuk ka patur ndryshime në aksionerët e Shoqërisë dhe në kuotat e tyre respektive.

Shoqëria është vendosur në Kashar, 5 km nga Tiranë (Shqipëri) dhe kishte 313 punonjës në 31 Dhjetor 2015 (2014: 301 punonjës).

2. Baza e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, jepet në paragrafët më poshtë:

(i) Humbje nga rënia e vlerës së aktiveve financiare

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme në vlerë. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në fitim ose humbje, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që të ketë një rënie të matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të mund të identifikohet me një ekspozim individual në atë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientit në Shoqëri, apo në gjendjen ekonomike lokale apo kombëtare që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të dukshëm siç përshkruhet në shënimin shpjegues 25.a të Shoqërisë.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(iii) *Përlllogaritja e tatim fitimit*

Drejtimi beson se përlllogaritja e tatimit mbi fitimin është e përshtatshme duke patur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi dhe rezultatet e ndonjë inspektimi të ardhshëm tatimor, nuk do të kenë ndikim të dukshëm në pozicionin financiar, rezultatit operativ apo flukset monetare të Shoqërisë. Megjithatë, si pasojë e natyrës së ligjit mbi tatimin e të ardhurave, praktikat dhe udhëzimet që shoqërojnë, nuk është e mundur që pozicioni aktual i ligjit tatimor nuk do të jetë sfidues nga autoritetet tatimore

5. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar qëndrueshëm në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në valutë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në valutë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të matur me vlerën e drejtë në valutë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetar që maten me koston historike në valutë përkthehen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit në përgjithësi njihen në fitim-humbje

(c) Instrumentat financiare

(i) *Instrumentat financiare jo-derivative*

Instrumentat financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshme nga klientë dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare, të pagueshme ndaj furnitorëve dhe të tjera të pagueshme, depozita me afat. Shoqëria njih fillimisht të arkëtueshmet dhe depozitat në datën e tyre të gjenerimit. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë të aktivitet financiar janë transferuar ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitet financiar. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara, që kualifikohet për çregjistrim, i mbajtur ose i krijuar nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

Aktivitet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon t'i shlyejë ato në baza neto ose të njohë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Instrumentat financiar jo-derivative maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e saj. Pas njohjes fillastare me vlerë të drejtë, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentat financiare (vazhdim)

(i) Instrumentat financiar jo-derivative (vazhdim)

Shoqëria ka aktive dhe detyrime financiare që përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, aktive të vlefshme për shitje, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme dhe janë më poshtë të shpjeguar në detaje:

Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat të pakufizuara me maturitet të mbetur 3 muaj ose më pak.

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me koston e amortizuar të pakësuar me humbjet për zhvlerësime.

Investimet financiare

Investimet financiare janë klasifikuar si aktive financiare të mbajtura për shitje. Në vijim të njohjes fillestare, ato janë matur me vlerën e drejtë dhe diferencat e krijuara, me përjashtim të humbjeve nga zhvlerësimet (shiko shënimin 5.f.i).

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme dhe të tjera njihen në vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar.

Të tjera

Instrumenta të tjera financiare jo-derivative maten në koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

Trajtimi kontabël për të ardhurat dhe shpenzimet financiare shpjegohen në shënimin 5(l).

Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

(d) Aktivët afatgjatë materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjatë materiale paraqiten me kosto ose kosto të supozuar të pakësuar për amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të atribueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse përfshihet në punime), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, koston e çmontimit dhe të zhvendosjes së njësive, kthimin e vendqëndrimit ku ato ndodhen dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes. Shpenzimet kapitale për kontributin në aktive kalojnë në llogarinë “Punime në proces” dhe kapitalizohen duke u transferuar në kategorinë e aktivit përkatës kur ai ka mbaruar, e në këtë kohë fillon dhe aplikohet amortizimi me normën përkatëse të kategorisë.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjatë materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjatë materiale.

Humbja ose fitimi nga shitja e një aktivit afatgjatë material përcaktohet nga krahasimi i të ardhurave nga shitja me vlerën kontabël të aktivit afatgjatë material, dhe njihet në neto në të ardhura të tjera/shpenzime të tjera, në pasqyrën e të ardhurave.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi bazohet në koston e aktivit afatgjatë material minus vlerën e tij të rikuperueshme. Komponentë të rëndësishëm të aktiveve të veçanta trajtohen individualisht dhe nëse ndonjë komponent ka jetëgjatësi të ndryshme nga pjesa tjetër e aktivit afatgjatë material ai komponent amortizohet individualisht.

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, me norma amortizimi të cilat i përafrojnë jetës së dobishme ekonomike. Toka, aktive të tjera dhe punimet në proces nuk amortizohen. Normat respektive të amortizimit për periudhën raportuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

	2015	2014
E drejta e përdorimit të tokës	1.01%	1.01%
Ndërtesa	2.5%	2.5%
Makineri dhe pajisje	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Ambalazh i kthyeshëm dhe frigoriferë	20%	20%
Pajisje zyresh, mobilje dhe orendi	20-25%	20-25%

Jeta e dobishme, metoda e amortizimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk janë të parëndësishme) të aktiveve materiale afatgjatë janë rishikuar në datën e raportimit.

(e) Inventarët

Mallrat vlerësohen me vlerën me të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme përfaqëson vlerën e llogaritur të çmimit të shitjes në aktivitetin normal të biznesit, të pakësuar për koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarët në gjendjen dhe vendin aktual.

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktive financiare

Një aktiv financiar konsiderohet për t'u zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të atij aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi e një aktivit financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv. Aktivet financiare individualisht të rëndësishëm që testohen për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivet që nuk janë individualisht të rëndësishëm vlerësohen për zhvlerësim mbi baza kolektive. Zhvlerësimi kolektiv realizohet duke grupuar aktivet me karakteristika të përbashkëta rrisht. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe reflektohen në një llogari zbritjeje.

Kur Shoqëria konsideron që nuk ekzistojnë prespektivë realiste mbi rikuperimin e aktivit, shumat respektive fshihen nga kontabiliteti. Në qoftë se shumata e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet më pas, dhe zbritja lidhet objektivisht me një ngjarje pas njohjes së zhvlerësimit, atëherë shumata e mëparshme e humbjes nga zhvlerësimi rimerret në fitim-humbje.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Zhvlerësimi (vazhdim)

(ii) Aktivitet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Për testimin e zhvlerësimit, aktivitet grupohen në grupin më të vogël të aktiveve që mund të gjenerojë flukse hyrëse nga përdorimi i tyre i vazhdueshëm dhe që janë të pavarur nga flukset hyrëse të aktiveve ose NJGJP-ve të tjera.

Shuma e rikuperueshme e një aktiviteti ose NGJP (Njësia Gjeneruese e Parasë) është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës drejtë minus kostot e shitjes. Vlera në përdorim është bazuar në flukset e parashikuara të cash-it, të skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe risqet specifike të aktivitetit ose NJGJP.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

(g) Përfitimet e punonjësve

Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

(h) Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe shuma e detyrimit mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjionet llogariten duke skontuar vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik ndaj detyrimit. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është akoma e mundur që të kërkohej një rrjedhje e burimeve duke personifikuar burime ekonomike për shlyerjen e detyrimeve, provigjionet anulohen. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimet për të cilat njihen fillimisht. Provigjionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Njohja e të ardhurave

(i) *Produkte dhe mallra*

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar për te mirat dhe shërbimet të siguruara gjatë aktivitetit normal të biznesit, neto nga kthimet, zbritjet tregtare uljet e emimit të bazuara në volume. Të ardhurat njihen kur ekziston evidencë bindëse, zakonisht në formën e një marrëveshje shetje të ekzekutuar, që rreziqet dhe përfitimet domethenese të pronësisë i janë transferuar blerësit, është e mundur marrja e shumës së konsideruar, kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme të të mirave janë të vlerësueshme në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të manaxhimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse është e mundur që zbritjet do të ekzekutohen dhe shuma e tyre është e matshme në mënyrë të besueshme, atëherë zbritjet njihen si pakësim i të ardhurave në momentin e njohjes së të ardhurave.

Momenti i transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve varion në varësi të termave individual të kontratës së shitjes. Për shitjet e produkteve industriale dhe tregtare; transferimi ndodh kur produktet janë ngarkuar në mjetin perkatës të transportit, vetëm nëse marrëveshja e shkruar shprehet ndryshe.

(ii) *Shërbimet*

E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në fitim ose humbje në proporcion me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Fazë e përfundimit është vlerësuar nga referencat e vëzhgimeve të punës së kryer.

(j) Rimbursimet e kostos së marketingut dhe të shitjes

Rimbursimet për programet e marketingut për të promovuar shitjen e produkteve të licensuara janë të njohura si të ardhura të vitit në të cilin kanë ndodhur edhe shpenzimet përkatëse. Rimbursimi i kostove të shitjes është njohur si e ardhur në të njëjtën kohë me shitjet e produkteve të cilave i referohet.

(k) Qiratë

Pagesat e bëra për qiratë operationale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë.

(l) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara në depozita bankare, fitimet nga shitjet e aktiveve financiare të gatshme për shitje dhe fitimet neto nga kursi i këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen dhe përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(m) Tatim fitimi aktual dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(i) Tatim fitimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshëm. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë nga Shoqëria të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin (në qoftë se ka). Ky tatim llogaritet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë është llogaritur në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivet tatimore të shtyra janë rishikuar në çdo datë raportimi dhe janë pakësuar për pjesën mbi të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitimi fiskal.

Aktive tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që bëhet e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do jenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren

Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rekuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivi tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(n) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pa adoptuara

Një seri standartesh të reja, rishikime dhe interpretime të standardeve ekzistuese do bëhen efektive për periudhat që fillojnë pas 1 Janar 2015; megjithatë Shoqëria nuk ka zbatuar këto standarde ose rishikime në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standard i ri ose rishikim	Përmbledhje e kërkesave	Efekti i mundshëm ne pasqyra financiare
SNRF 9 <i>Instrumentat financiare</i>	SNRF 9, publikuar në korrik 2014, zëvendëson standardin ekzistues SNK 39 Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9, përmban udhëzime të rishikuara mbi klasifikimin dhe matjen e instrumentave financiarë, përfshirë një model të rihumbje kredie të pritshme për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesa të reja mbi kontabilitetin mbrojtës. Gjithashtu mbart udhëzimet mbi njohjen e ç'rregjistrimin e instrumentave financiarë nga SNK 39. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, me zbatim më të hershëm të lejuar.	Shoqëria vlerëson efektin e mundshëm si rezultat i zbatimit të SNRF 9 në pasqyrat financiare. Nisur nga natyra e operacioneve të Shoqërisë, ky standard nuk do të ketë një ndikim të përhapur në pasqyrat financiare. .
SNRF 15 <i>Të ardhurat nga kontratat me klientët</i>	IFRS 15 paraqet parimin themelor, si dhe kur që të ardhurat duhet të njihen Ai zëvendëson standardet dhe udhëzimet ekzistuese, duke përfshirë SNK 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet për Besnikërinë e Klientëve. Standard i ri prezanton parimin themelor që të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet janë transferuar klientit me çmimin e transaksionit. Çdo paketë mallrash dhe shërbimesh që janë të dallueshëm, njohja duhet bërë në mënyrë të ndarë dhe çdo skonto apo zbritje e aplikuar duhet të alokohet elementëve në mënyrë të ndarë Kur konsiderata varion për çdo arsye, shumat minimale duhet të njihen në qoftë se ato nuk paraqesin rrezik të rëndësishëm rimarrjeje. Kostot e ndodhura për të siguruar kontrata me klientët duhen kapitalizuar dhe amortizuar përgjatë periudhës për të cilat përfitimet nga kontrata konsumohen. Shoqëria po vlerëson efektin potencial në pasqyrat e veta financiare që rezultojnë nga aplikimi i IFRS 15.	Shoqëria vlerëson efektin e mundshëm si rezultat i zbatimit të SNRF 15 në pasqyrat financiare

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

5. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(n) Standardet e reja ende të pa adoptuara (vazhdim)

Efektive për raportime vjetore që nisin më ose pas 1 janar 2016

- SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore
- Ndryshimet ndaj SNRF 11: Marrëveshjet e kontrolluara bashkërisht
- Ndryshimet ndaj SNRF 10, 12 and IAS 28: Entitetet investuese- aplikimi i përjashtimit të konsolidimit
- Ndryshimet ndaj SNK 16 dhe SNK 38: Sqarime mbi metodat e pranuar të amortizimit dhe zhvlerësimit
- Ndryshimet ndaj SNK 1: Nisma e dhënies së informacionit shpjeguese
- Ndryshimet ndaj SNK 16 dhe SNK 41: Bimët bartëse
- Ndryshimet ndaj SNK 19: Planet e përcaktuara te kontributeve të punonjësve
- Ndryshimet ndaj SNK 27: Metoda e kapitalit neto në një pasqyrë financiare të veçantë;

Efektive për raportime vjetore që nisin më ose pas 1 janar 2017

- Ndryshimet ndaj SNK 7: Nisma e dhënies së informacionit shpjeguese
- Ndryshimet ndaj SNK 12: Njohja e Aktiveve Tatimore të Shtyra për Humbjet të Perealizuara

Data efektive nuk është përcaktuar ende, por një adoptim i hershëm lejohet për:

- Ndryshimet ndaj SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose kontributi me aktive midis një investitori dhe sipërmarrësi të tij të përbashkët

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë:

<i>Kosto</i>	Tokë	E drejta e përdorimit të tokës	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Ambalazh i rikthyeshëm, frigorifere dhe paj.publicitare	Mobilje dhe Pajisje zyre	Të Tjera	Punime në proces	Totali
Më 1 Janar 2014	7,600,210	62,700,000	807,108,899	1,370,248,333	164,441,535	355,117,164	122,594,069	4,499,734	7,373,195	2,901,683,139
Shtesa	1,497,000	-	4,857,227	13,329,325	2,083,890	52,697,674	5,096,749	34,900	5,038,270	84,635,035
Transferime	-	-	-	10,632,657	-	-	-	-	(10,632,657)	-
Pakësime	-	-	-	(139,720)	(1,401,444)	(5,086,217)	-	-	-	(6,627,381)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	(1,816,527)	(2,140,300)	(31,429,168)	(3,961,819)	(79,100)	-	(39,426,914)
Më 31 Dhjetor 2014	9,097,210	62,700,000	811,966,126	1,392,254,068	162,983,681	371,299,453	123,728,999	4,455,534	1,778,808	2,940,263,879
Shtesa	2,381,718	-	42,000	19,701,215	25,824	58,245,596	28,189,268	141,570	-	108,727,191
Transferime	-	-	-	-	-	-	473,803	-	-	473,803
Pakësime	-	-	-	-	-	(11,579,242)	-	-	-	(11,579,242)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	(4,674,497)	(28,577,202)	(29,817,476)	(6,902,371)	(109,942)	-	(70,081,488)
Më 31 Dhjetor 2015	11,478,928	62,700,000	812,008,126	1,407,280,786	134,432,303	388,148,331	145,489,699	4,487,162	1,778,808	2,967,804,143
<i>Amortizimi i akumuluar</i>										
Më 1 Janar 2014	-	(12,665,400)	(234,970,311)	(1,063,160,392)	(114,328,615)	(177,939,252)	(79,752,601)	(217,778)	-	(1,683,034,349)
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(14,377,430)	(64,540,563)	(10,174,646)	(41,262,426)	(11,026,447)	-	-	(142,014,782)
Pakësime	-	-	-	29,807	1,168,572	2,805,847	-	-	-	4,004,226
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	1,440,536	1,449,834	23,555,054	3,353,673	24,915	-	29,824,012
Më 31 Dhjetor 2014	-	(13,298,670)	(249,347,741)	(1,126,230,612)	(121,884,855)	(192,840,777)	(87,425,375)	(192,863)	-	(1,791,220,893)
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(14,066,247)	(55,569,057)	(8,221,489)	(43,071,566)	(11,284,612)	-	-	(132,846,241)
Pakësime	-	-	-	-	-	7,905,596	-	-	-	7,905,596
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	3,421,379	26,693,127	22,285,592	5,441,251	39,399	-	57,880,748
Më 31 Dhjetor 2015	-	(13,931,940)	(263,413,988)	(1,178,378,290)	(103,413,217)	(205,721,155)	(93,268,736)	(153,464)	-	(1,858,280,790)
<i>Vlera kontabël</i>										
Më 1 Janar 2014	7,600,210	50,034,600	572,138,588	307,087,941	50,112,920	177,177,912	42,841,468	4,281,956	7,373,195	1,218,648,790
Më 31 Dhjetor 2014	9,097,210	49,401,330	562,618,385	266,023,456	41,098,826	178,458,676	36,303,624	4,262,671	1,778,808	1,149,042,986
Më 31 Dhjetor 2015	11,478,928	48,768,060	548,594,138	228,902,496	31,019,086	182,427,176	52,220,963	4,333,698	1,778,808	1,109,523,353

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(shumat në Lek)

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Toka në përdorim përfaqëson kontributin në natyrë nga aksionari, Invest P.F në kapitalin aksionar. E drejta e përdorimit të tokës në të cilën ndodhet ndërtesa e Shoqërisë është e vlefshme për nëntë dhjetë e nëntë (99) vite që nga fillimi i aktivitetit të Shoqërisë. Qirasë e mbaron afati në vitin 2092 dhe ka një amortizim vjetor 633,270 Lek.

Më 31 Dhjetor 2015, kategoria makineri dhe pajisje përfshin edhe investimin e bërë për linjën e prodhimit me paketim KEGS 18Lt, me një kosto historike 8,204,678 Lek (2014: 4,080,854 Lek) dhe amortizimi përkatës i akumuluar në vlerën 1,542,409 Lek (2014: 816,171 Lek).

Sigurime

Nuk ka ndonjë aktiv afatgjatë material të lënë si kolateral për ndonjë kredi deri më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014.

Amortizimi

Amortizimi paraqitet në zërin kostoja e mallrave të shitur për vlerën 70,268,574 Lek (2014: 85,802,539 Lek) dhe në shpenzime amortizimi për vlerën 62,577,667 Lek (2014: 56,212,243 Lek).

7. Investimet financiare

